



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KRYETARI

Nr. 11587/2 prot.

Vlorë, më 16.07 2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, Datë, _____.____ 2025

“PËR NISJEN E PROCEDURËS PËR DHËNIEN NË PËRDORIM ME AFAT DERI NË 10 VJET ME TË DREJTË RINOVIMI TË SIPËRFAQES KULLOSORE QË BËN PJESË NË EKONOMINË SHASHICË-GUMENICË, NGA STRA 3 ME SIPËRFAQE 48.8 HA, NR.SERIAL 262, DATË 08.05.2023, NGA STRA 4 ME SIPERFAQE 104.25 HA NR.SERIAL 256, DATE 05.05.2023, NGA STRA 8 ME SIPËRFAQE 410.43 HA NR.SERIAL 257, DATË 05.05.2023, NGA STRA 9 ME SIPËRFAQE 145.53 HA ME NR.SERIAL 258 ,DATË 05.05.2023, NGA STRA 10 NR. SERIAL 259, DATË 05.05.2023 ME SIPËRFAQE 122.54 HA, PËR VEPRIMTARI FOTOVOLTAIKE “

Bazuar në ligjin nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në Ligjin nr.139/2015 ”Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 8, pika 2, neni 9/1, pika 1/b dhe 7/a, neni 54, pika m, të ligjit nr.57/2020 “ Për pyjet”, neni 25, ligjit nr.9693, datë 19.03.2007 ” Për Fondin Kullosor”, në VKM nr. 433, datë 08.06.2016 për "Transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit ", në VKM-në nr.559, datë 29.07.2022 “ Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore”, në Udhëzimin Nr.1, datë 09.06.2016” Për rregullat procedurat e kerkimit, të shqyrtimit, e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik, si dhe në bazë të Relacionit bashkëlidhur këtij projekt vendimi :

VENDOSI:

1. Të nisi procedurën për dhënien në përdorim të sipërfaqes Kullosore prej 831.42 m² “ Shashicë-Gumenicë në pronesi të bashkisë Vlorë, ngastra 3 me sipërfaqe 48.8 ha, ngastra 4 me sipërfaqe 104.25 ha, ngastra 8 me sipërfaqe 410.43 ha, ngastra 9 me sipërfaqe 145.53 ha, ngastra 10 me sipërfaqe 122.54 ha, për veprimtari fotovoltaike.

2. Afati i dhënies me qira propozohet të jetë deri në 10 (dhjetë) vjet me të drejtë rinovimi për aq kohë sa është përdorimi i veprimtarisë së kërkuar kur subjekti paguan qeranë vjetore.

3. Vlera e dhënies me qira është përllogaritur sipas vendimit nr.559, datë 29.07.2022 “ Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të Fondit Pyjor Kombëtar, për veprimtari Ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore”

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë Vlorë.

Ky Vendim hyn në fuqi bazuar në ligjin nr.139/2015” Për vetëqeverisjen vendore neni 55 pika 6 .

KRYETAR

Ermal Dredha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 11585/12 prot.

Vlorë, më 16.07 2025

RELACION

MBI PROJEKT - VENDIMIN “PËR NISJEN E PROCEDURËS PËR DHËNIEN NË PËRDORIM ME AFAT DERI NË 10 VJET ME TË DREJTË RINOVIMI TË SIPËRFAQES KULLOSORE QË BËN PJESË NË EKONOMINË SHASHICË-GUMENICË, NGA STRA 3 ME SIPËRFAQE 48.8 HA, NR.SERIAL 262, DATË 08.05.2023, NGA STRA 4 ME SIPËRFAQE 104.25 HA NR.SERIAL 256, DATE 05.05.2023, NGA STRA 8 ME SIPËRFAQE 410.43 HA NR.SERIAL 257, DATË 05.05.2023, NGA STRA 9 ME SIPËRFAQE 145.53 HA ME NR.SERIAL 258 ,DATË 05.05.2023, NGA STRA 10 NR. SERIAL 259, DATË 05.05.2023 ME SIPËRFAQE 122.54 HA, PËR VEPRIMTARI FOTOVOLTAIKE “

PARA KËSHILLIT TË BASHKISË

Të nderuar Këshilltarë!

Po ju paraqesim këtë Projekt Vendimi në cilësinë e përfaqësuesit të të drejtave pronësore të pasurive të paluajtshme të Bashkisë Vlorë. Qëllimi i këtij projekt-vendimi është miratim në Këshillin e Bashkisë Vlorë, dhënie në përdorim me afat deri në 10 vjet me të drejtë rinovimi, të sipërfaqes Kullosore Shashicë-Gumenicë, ngastra 3 me sipërfaqe 48.8 ha, ngastra 4 me sipërfaqe 104.25 ha, ngastra 8 me sipërfaqe 410.43 ha, ngastra 9 me sipërfaqe 145.53 ha, ngastra 10 me sipërfaqe 122.54 ha, të cilat plotësojnë kushtet e favorshme klimaterike për veprimtari fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë.

Bashkia Vlorë, e orientuar në politikat e qeverisë Shqiptare për strategjinë dhe rritjen e përdorimit të burimeve alternative të energjisë, reflektuar kjo në Vkm nr.872 datë 29.12.2021 “ Për miratimin e Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën”, bazuar në prioritetet e Bashkisë Vlorë për zhvillimin ekonomik si dhe në legjislacionin në fuqi për sipërfaqet pyjore në të cilat mund të ushtrohet veprimtari ekonomike, i vlerëson veprimtaritë e mësipërme në përputhshmëri me aktet ligjore në fuqi, parimet për zhvillimin e qëndrueshëm silvikulturor dhe biologjik të ekosistemit, si edhe mirëadministrimin e tokës publike.

Kjo strukturë ka si qëllim parandalimin e degradimit të pyjeve dhe tokave pyjore nga faktorët njerëzorë dhe natyrorë, me synim përmirësimin e mjedisit pyjor në tërësi, rritjen e të ardhurave për bashkinë të cilat përkthehen në investime për fondin pyjor.

Veprimtaria e mësipërme do të ketë ndikim pozitiv në të ardhmen për gjenerimin e të ardhurave për komunitetin e zonës përreth dhe rritjen e vlerave ekonomike në zonë, kjo zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi konkretisht ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr.57/2020 “Për Pyjet”, Neni 1, “Qëllimi i ligjit”, Neni 2, “Objekti dhe fusha e zbatimit” Kreu V, neni 23, “Kategoritë e përfitimeve dhe rregullat për shfrytëzimin e fondit pyjor kombëtar”, Neni 25, “Përfitimet nga shfrytëzimi i fondit pyjor kombëtar”, Ligjit nr.9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullosor” neni 17 pika 3, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.559, datë 29.07.2022, “Për përcaktimin e tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore”.

Nëse ky projekt-vendim, miratohet nga ju si ushtrues të së drejtës së pronës, Bashkisë i lind e drejta të nisë procedurat e dhënies me qera, procedura të cilat janë të mbështetura, në ligjin nr.57/2020 “Për pyjet neni 25 pika 1 c, në Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr.1, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave të dhëna në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik” si edhe në ligjin me Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Përpara lidhjes së kontratës nëse ekzistojnë pretendime apo mosmarrëveshje lidhur me pronësinë e kësaj prone., Bashkia Vlorë do të ndërmarë të gjitha masat e nevojshme për kryerjen e verifikimeve mbi pronën objekt qeraje,

Për këtë qëllim në datë 03.12.2024 nga administrata e Bashkisë Vlorë u bë konsultimi publik me grupet e interesuara kryesisht në fshatin Kaninë ku shtrihet sipërfaqja objekt i këtij projekt vendimi, ku ka patur edhe shprehje mosdakortësie nga disa banorë.

Duke i vlerësuar këto pretendime edhe pse nuk janë shoqëruar me dokumentacionin përkatës, administrata e bashkisë në momentin e fillimit të procedurës së prokurimit do të bazohet vetëm te pasuritë në pronësi të Bashkisë Vlorë, për pasuritë pronë private marrëveshjet do të lidhen privatisht.

Theksojmë gjithashtu se miratimi i marrëveshjes do të jetë nëpërmjetë procedurave të prokurimit bazuar në dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë procedurat përkatëse për projekte të tilla.

Referuar ligjit nr.57/2020 “për pyjet”, neni 25, pika 1 c në udhëzimin e ministrit të Mjedisit nr.1, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”, jepen në përdorim në një afat 10 vjeçar.

Tarifa e dhënies në përdorim nga fondi pyjor kullosor do ti referohet VKM-së nr.559, datë 20.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar” bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucionet përkatëse dhe kategorinë e përdorimit.

Sipërfaqja totale që bënë pjesë në Ekonominë Kullosore Shashicë-Gumenicë është 831.42 ha x 176.000 lekë=148.096.000 lekë, shumë e cila do të kalojë në favor të Bashkisë Vlorë.

Sipërfaqja totale e cila do ti nënshtrohet impianteve fotovoltaike dhe kontratave të cilat do të lidhen më subjektet e interesuara, do të jetë më kusht **“Pezullues”**: Që do të thotë se subjektet (Qiramarrës), do të pajisen me Kontratën Perfundimtare të Qirasë në momentin e miratimit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas parashikimeve të ligjit 43/2015 “ Për sektorin e energjisë elektrike” dhe akteve përkatëse ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të tij.

Energjia diellore është plotësisht e lirë nga çdo mbetje ndotëse dhe aktualisht është vendosur në alternativat më të mira për të zvogëluar emetimet e gazeve serë që shkaktohen nga lëndët djegëse fosile si gazi, nafta dhe qymyri të cilat janë burime ndotëse që po shkaktojnë probleme mjedisore në një shkallë globale siç janë ndryshimet klimatike.

A ia vlen të investohet në panele fotovoltaike?

Sigurisht që për pjesën më të madhe të bizneseve apo individëve arsyeja kryesore e investimeve në panele fotovoltaike është ulja e kostove të energjisë elektrike. Çmimet e impianteve fotovoltaike kanë rënë ndjeshëm në vitet e fundit. Kjo e bën këtë një investim të favorshëm. Gjithashtu, kjo teknologji sjell përfitime edhe në zonat të cilat nuk kanë akses në rrjetin elektrik.

Avantazhi më i madh i energjisë diellore kundrejt asaj hidro është impakti që ajo ka në mjedis. Në ndryshim nga hidrocentralet, impiantet fotovoltaike nuk kanë asnjë lloj impakti negativ në mjedis, duke e bërë kështu një teknologji totalisht environmental friendly. Gjithashtu, impiantet fotovoltaike kanë nevojë për një mirëmbajtje minimale. Kjo do të thotë që pas investimit fillestar, energjia ë prodhuar për të paktën 25 vitet në vijim është me kosto 0.

Ekonomia shqiptare është duke u zhvilluar me ritme të shpejta në drejtim të integritimit të saj rajonal, evropian dhe botëror. Vendi ynë aktualisht është duke u përballur me sukses me sfidat e integritimit në Bashkimin Evropian, gjë e cila përfshin angazhimin për ndërtimin e kapaciteteve të reja ekonomike, përshtatjen e teknologjive, si dhe integrimin e ekonomisë shqiptare në hartën e tregjeve rajonale dhe ndërkombëtare.

Ky përbën një proces kryesor për të garantuar koherencën dhe vazhdimësinë e strategjive, të reformave, si dhe të prioritetëve të ekonomisë shqiptare, të cilat janë të nevojshme në kushtet e një ekonomie të tregut të lirë. Arritja e këtyre objektivave parësore do të bëhet e mundur nëpërmjet politikave efektive, konsolidimit dhe zhvillimit të sektorëve kryesorë të ekonomisë kombëtare, konsolidimit të institucioneve dhe hartimit e implementimit të projekteve, të cilët realisht do ta integrojnë ekonominë Shqiptare, duke u bazuar në drejtimet kryesore të “Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim”, si dhe në strategjitë sektoriale dhe rajonale.

Përprojekjet konstante për harmonizimin e politikave të rritjes ekonomike me kërkesat e standardeve mjedisore, përbejnë gjithashtu një drejtim tjetër themelor të programeve të Qeverisë për një zhvillim të qëndrueshëm të vendit. Pavarësisht se furnizimi i vendit me produkte primare energjitike ka ardhur gjithmonë në rritje, tregu vendas ka mbetur deficitar në furnizimin si me energji elektrike, ashtu dhe me produkte hidrokarbure, ku shkak i rëndësishëm është fakti që vendi ynë nuk ka arritur të realizojë diversifikimin e furnizimit me burime energjetike (ende nuk është i lidhur me rrjetin ndërkombëtar të gazit natyror, ndërkohë që ende nuk janë përfunduar lidhjet e interkonjeksionit elektroenergjetik me rajonin), si dhe ka kapacitete gjenerues të pamjaftueshëm për të plotësuar kërkesën në rritje për energji elektrike në vend edhe kur kushtet hidrologjike janë të favorshme.

Problemet e furnizimit me burime energjetike kanë ndikuar që ende të ketë nivele të ulëta të aktivitetit ekonomik si dhe nivel të minimumit jetik për një numër të madhë popullsie. Eksperienca e vendeve të zhvilluara ka treguar se, për të pasur një zhvillim normal të sektorit energjetik duhet të vendoset një balancë e drejtë ndërmjet politikave qeverisëse dhe mekanizmave të tregut, si dhe menaxhimit të energjisë.

Pikërisht në këtë kontekst janë vlerësuar dhe trajtuar projektet që duhet të ndiqen për sektorin energjetik, duke përfshirë edhe ato që lidhen me zhvillimin e zonave me aktivitet kompleks sikurse mund të jënë zonat energjitike dhe industriale, nëpërmjet të cilëve evidentohen investimet përkatëse në vlerë (për burime gjenerimi, apo linja dhe rruge të transmetimit), si dhe koha e domosdoshme, që duhet për t'i realizuar ato.

Rritja ekonomike dhe zhvillimi tërësor i vendit kanë kërkuar dhe kanë nxitur ndërtimin e objekteve të reja energjetike e industriale, për të cilat ne ecuri janë paraqitur kërkesa e propozime konkrete, mjaft prej të cilave janë fokusuar në shfrytëzimin e burimeve natyrore, si ky projekt në vlerësim.

Kalimi i kullotave në administrim të Njësisë të Qeverisjes Vendore ka patur për qëllim mirëadministrimin e tyre në funksion të komunitetit. Dhënia e tyre me kontrata afatgjata duke mbajtur parasysh zhvillimin e zonës dhe rehabilitimin e pyjeve dhe kullotave mbas shfrytëzimit të saj është në përputhje të plotë me planet dhe prespektivën e zhvillimit.

Në këto kushte, kërkojmë nga Këshilli Bashkiak të shprehë dakortësinë për dhënien në përdorim të sipërfaqes kullimore, në pronësi të Bashkisë Vlorë, me afat deri në 10 vjet, me të drejtë rinovimi për atë kohë sa është përdorimi i veprimtarisë së kërkuar kur subjekti paguan qeranë vjetore.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

DREJTOR JURIDIK

Anisa Plepi